



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E
MBAJTUR MË 24 KORRIK 2009**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
24. JULA 2009. GODINE**

**KORRIK – JULI
2009**

Sancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Të nderuar deputet,

I nderuari Kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e Seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 66 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar me punë.

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 6.2 dhe 23 e Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia paraqet rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Rendin e ditës e keni marrë. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës të kësaj seance.

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-105 të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë në seancën e djeshme, më 23 korrik 2009. Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit për vitin 2009 dhe i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raporti i komisionit funksional iu është shpërndarë deputetëve. Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, ftoj kryetarin e komisionit funksional, zotin Gani Koci, nëse e sheh të nevojshme arsyetimin e Raportit me rekomandime. Nuk e sheh të nevojshme. Ju faleminderit!

Atëherë, procedojmë me votimin dhe miratimin e amendamenteve, sipas radhitjes të paraqitur në raport.

Amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit për vitin 2009. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për ta votuar amendamentin e parë.

Amendamenti 1

Votojmë tash.

Me 67 vota “për”, 7 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Votojmë tash.

Me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë tash.

Me 65 vota “për”, 8 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash.

Me 64 vota “për”, 4 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Votojmë tash.

Me 64 vota “për”, 4 “kundër”, 5 abstenime miratohet amendamenti 5.

Në sallë kemi 80 deputetë.

Amendamenti 6

Votojmë tash.

Me 65 vota “për”, 4 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7

Votojmë tash.

Me 69 vota “për”, 4 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8

Votojmë tash.

Me 64 vota “për”, 5 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Votojmë tash.

Me 69 vota “për”, 3 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 9 dhe i fundit.

Tani përgatitemi për të votuar Ligjin në tërësi.

Votojmë tash.

Me 69 vota “për”, 5 “kundër”, 2 abstenime, miratohet Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009. Ju faleminderit!

(duartrokitje)

Urdhëro, ministër, dy fjalë! Nuk ka nevojë, por qe po ia jap fjalën.

(Reagime nga salla)

MINISTRI AHMET SHALA: Unë desha, u pajtuam parimisht që paraprakisht t’i them ca fjalë, por u mbeta borxh disa shokëve e miqve, natyrisht edhe partnerëve edhe të koalicionit, edhe të tjerëve, t’i them disa fjalë. Në emër të Qeverisë së Kosovës i falënderoj të gjithë, e mora lejen edhe prej Kryeministrit që në emër të tij t’i falënderoj

të gjithë ata që kanë kontribuar dhe, natyrisht, kam pasur kërkesa të shumta edhe me arsye, mbase edhe duke mos i kuptuar prioritetet edhe konkurrencat e projekteve sipas prioriteve, ne zotohemi që disa nga projektet e ngritur këtu, mbase me shumë arsye, nganjëherë me tone më të larta dhe duke mos kuptuar prioritetet që i kemi para nesh, disa nga kolegët tonë këtu edhe të koalicionit dhe, me qenë se nuk mund t'i fusim në këtë ndryshim, neve zotohemi që gjatë proceseve të rregullta buxhetore të vitit 2010, do t'i kemi parasysh ato. Lidhja e regjioneve dhe e komunave është prioritet i Ministrisë së Transportit, është prioritet i Qeverisë së Kosovës dhe ajo do të bëhet, kështu që ato zëra që u ngritën pa dashur tash të nxis ndonjë rast të veçantë, do të merren parasysh në projektimet tona buxhetore dhe për këtë e kemi mbështetjen edhe të Kryeministrit edhe të Qeverisë së Kosovës dhe do ta bëjmë bashkë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik të Kosovës, nr. 02/L-99

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik të Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raportet me rekomandimet e komisioneve u janë shpërndarë deputetëve. Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Kocin, nëse ka për të thënë ndonjë gjë. Nuk do ta marrë fjalën, vazhdojmë. Vazhdojmë procedurën e votimit të amendamenteve.

Kemi gjithsej 6 amendamente. Regjia, përgatitet për votim.

Amendamenti 1

Votojmë tash.

Me 63 vota “për”, 2 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Në sallë kemi 91 deputetë

Amendamenti 2

Votojmë tash.

Me 67 vota “për”, 1 “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë tash.

Me 68 vota “për”, 1 “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash.

Me 61 vota “për”, 1 “kundër”, 11 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Votojmë, tash.

Me 58 vota “për”, 2 “kundër”, 9 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6 dhe i fundit.

Votojmë tash.

Me 64 vota “për”, 2 “kundër”, 9 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin e Projektligjit me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Me 70 vota “për”, 8 “kundër”, 6 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit, nr. 2003/17 për Prokurimin publik, të ndryshuar me Ligjin nr. 02/L-99. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i propozimit të Kryesisë së Kuvendit për formimin e tri komisioneve parlamentare.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 21 korrik 2009, vendosi që Kuvendit t’i propozojë formimin e tri komisioneve parlamentare.

Propozim-vendimi i Kryesisë së Kuvendit iu është shpërndarë deputetëve. A ka nevojë për deklarimin e shefave të grupeve parlamentare? Nuk ka nevojë. Materialin e keni marrë, atëherë lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Me 81 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi formimin e tri komisioneve parlamentare me nga 9 anëtarë:

1. Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike,
2. Komisionin për Mbikëqyrjen e Agjencionit Kosovar për Inteligjencë dhe
3. Komisionin për Mbikëqyrjen e Forcës të Sigurisë së Kosovës. Edhe për këtë ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Përkohshëm Gjyqësor

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me Ligjin për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka rekomanduar kandidatët për anëtarë të Këshillit të Përkohshëm Gjyqësor.

Rekomandimi i komisionit iu është shpërndarë deputetëve. Para se të procedojmë me votimin e rekomandimit të komisionit, ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, zotin Bahri Hyseni, që para deputetëve ta arsyetojë Raportin me rekomandime.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritet, Kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion, duke u mbështetur në nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe duke u mbështetur në Ligjin për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në nenin 1.2, 1.3 dhe 1.4 ka shqyrtuar sot në Komision kandidatët e mundshëm për anëtarë të Këshillit të Përkohshëm Gjyqësor të Kosovës.

Me rastin e shqyrtimit, Komisioni ka konstatuar, meqë Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk vepron për një kohë të gjatë, pothuaj për shtatë-tetë muaj dhe, meqë shtylla e tretë e pushtetit ka mbetur pa organin mbikëqyrës të organeve të drejtësisë, duke marrë parasysh që ne jemi në përfundim të reformës për emërimin e gjykatësve dhe të prokurorëve të rinj në Kosovë, të cilët po e presin për çdo ditë emërimin e Këshillit të Përkohshëm, me përbërje të përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, e ka parë të arsyeshme, duke marrë parasysh edhe situatën që për shtatë-tetë muaj gjykatat kanë mbetur pa e plotësuar numrin e caktuar të gjykatësve dhe të prokurorëve të cilët edhe për raste të ndryshme ose janë shkarkuar ose ka pasur raste që kanë vdekur, i propozon Kuvendit të Kosovës sot anëtarët e mundshëm të përkohshëm të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

1. Lirije Osmani,
2. Zhivojin Jakanović, dhe
3. Bilgajip Maznika

Prandaj, kërkoj që ky Kuvend t'i votojë anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Shefat nuk ka nevojë të deklarohen. Ju faleminderit! Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.

Votojmë tash.

Konstatohet se me 68 vota “për”, 11 “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi emëroi Lirije Osmanin, Zhivojin Jakanović dhe Bilgajip Maznika, anëtarë të Këshillit të Përkohshëm Gjyqësor të Kosovës.

Me këtë votim, kjo seancë përfundoi.

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale.